



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova



Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Dëgjimi publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026 – Fshati Lluzhan

Dëgjimin publik i cili u mbajt në fshatin Lluzhan për buxhetin e vitit 2024-2026, u hap diskutimi nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, duke krahasuar buxhetin e vitit 2023 me atë të vitit 2024. Për këtë rritje progresive, Drejtori Osmani theksoi se buxheti për vitin 2024 është në rritje afër 4 milion euro.

Arsyeja e këtij debati publik ishte diskutimi për KAB për 2024-2026, ku bashkë me Drejtorin Osmani ishin Drejtori i Urbanizmit, Leutrim Krasniqi, Drejtoresha e Kadastrit, Saranda Stublla dhe Drejtoresha e Administratës, Antoneta Ejupi.

Drejtori Osmani theksoi sektorët të cilat i ka prioritet Komuna për investim duke filluar nga arsimit, shëndetësia, infrastruktura, shërbimet publike dhe të gjitha sektoret e tjera.

Gjithashtu, drejtori Osmani tha se të gjitha këto propozime dhe kërkesa që po i marrim nga ju janë për arsye që të inkuadrohen në Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe të kthehen në investimet për komunitetin. Po ashtu tha se kjo rritje buxhetore mundëson zhvillimin e projekteve të rëndësishme për zhvillimin social dhe ekonomik- shoqëror të Komunës së Podujevës.

Për prioritetet që ka pasur Komuna gjatë këtyre 2 viteve të fundit ka treguar, drejtori Osmani i cili tha se sektoret më me prioritet kanë qenë, arsimit, kultura, bujqësia, por që gjithashtu ka pas edhe projekte të rëndësishme në sektorin e infrastrukturës në mënyrë që këto investime të përmirësojnë jetën e qytetarëve të Komunës së Podujevës.

Në sektorin e arsimit, drejtori Osmani tha se ka pasur rritje të konsiderueshme të buxhetit duke krahasur me atë të vitit 2021, që ka një rritje prej afër 15 herë. Gjithashtu edhe për sektorin e shëndetësisë ka pasur një rritje të konsiderueshme, kanë përfunduar projekte në mëdha në fushën e shëndetësisë dhe është bërë furnizimi me barna dhe materiale të tjera shëndetësore.

Drejtori Osmani theksoi se ka pasur rritje prej afër 5 herë të buxhetit për fushën e kulturës dhe të sportit. Ndërsa edhe për fushën e bujqësisë ka shtuar se ka rritje të buxhetit, ku nga 460mijë euro, tashmë jemi afër 700mijë euro subvencione për vitin 2023.

Për rritjen e buxhetit që është afër 4milion, drejtori Osmani ka theksuar se një shumë e konsiderueshme do të shkoj në kategorinë e pagave për shkak të inkuadrimin të ligjit të pagavë, mirëpo si Komunë prioritet i kemi investimet kapitale të cilat janë duke u realizuar dhe rritjen e subvencioneve.

Nuredin Hyseni, banorë i fshatit Bollopoj- Kërkon furnizimin me ujë të pijes në fshatin Bollopoj, gjithashtu kërkon asfaltimin e rrugës në lagjen e Rudarëve, rregullimin e ndriqimit po në atë lagje dhe përfundimin e rregullimit të trotuareve.

Përparim Çunaku, banor i fshatit Lluga- Kërkon nga Komuna ndërtimin e shkollës së fshatit Lluzhan, rregullimi e ujërave të zeza dhe të planifikohet ndërtimi i një shkolle të mesme të lartë në fshatin Lluzhan dhe gjithashtu të ndërtohet në Komunën e Podujevës një shkollë e mesme bujqësore.

Drejtori i Urbanizmit, Leutrim Krasniqi ka shtuar për çështjen e ujësjellësit se është në kuadër të KRU Prishtina, por që si çështje do ta përcjellin tek kjo kompani. Ndërsa, për asfaltim të rrugës në lagjen e rudarëve ka thënë të drejtohen në Drejtorinë e Urbanizmit për të parë saktë vendin se ku gjenden ato rrugë dhe më pas të bëhet shqyrtimi i mundësisë së asfaltimit nga ana e komisionit komunal.

Kurse, për ndriqimin e rrugëve drejtori Krasniqi ka shtuar se është në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, por që si çështje do ta adresojë te Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bahri Selimi. Ndërsa, për rrugën kryesore të fshatit, drejtori Krasniqi ka treguar se është nënshkruar kontrata për rregullimin e asaj rruge dhe trotuareve të dëmtuara, ku kjo kontratë është 2 vjeçare dhe brenda këtyre dy viteve do të trajtohet ky segment rrugor.

Për kërkesën e ujërave të zeza, drejtori Krasniqi ka treguar se tashmë është në procedurë të prokurimit ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza dhe jemi në nënshkrimin e kontratës për fillimin e punimeve.

Drejtori Osmani ka shtuar për kërkesën e ndërtimit të shkollës së Lluzhanit, është projekti vetëm për rikonstruktimin e shkollës, ku ky objekt do të kthehet në gjendje moderne, funksional dhe i

përshtatshëm për zhvillimin e procesit arsimor në këtë shkollë. Mirëpo, për ndërtimin e objektit të ri nuk është në planifikimet buxhetore Afatmesme të Komunës së Podujevës.

Drejtori Osmani gjithashtu ka theksuar se gjatë vitit 2023 do të hapet çerdhja në fshatin Lluzhan, ku tashmë furnizimi me inventar është në procedura të prokurimit.

Lidhur me ndërtimin e shkollës së mesme profesionale, drejtori Osmani ka treguar se tashmë kanë filluar procedurat e prokurimit për ndërtim të shkollës së mesme ekonomike, e që shkolla e mesme ekonomike që është tani do të kthehet në shkollë fillore. Kurse, deri në ndërtimin e shkollës profesionale bujqësore, do të shqyrtohet si mundësi të hapen paralele që kanë të bëjnë me teknologji ushqimore.

Por, që gjithashtu do të ketë edhe investime të tjera në fushën e arsimit, ku do të bëhet edhe digjitalizimi i instituconeve arsimore.

31 maj, fshati Lluzhan



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 (KAB), banorët e fshatit Lluzhan dhe fshatrave përreth.

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrëseve:

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	MURADIX HAJR	BOLLPOZ	
2	Kim Gualu	HUGA	
3	Përparim Gualu	HUGA	
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			

22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			

Vërejtje: Nënshkruhen të gjithë ata persona të cilët pajtohen që të dhënat e tyre dhe fotot mund të përdoren për publikim e procesit të konsultimeve në ueb faqen zyrtare të Komunës së Podujevës.

Podujevë

31.05.2023



Debat publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)



Debat publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)